

ALARM TATIMOR

3 Mars 2020

Për t'ju informuar me ndryshimet më të fundit në legjislacionin Shqiptar, ky alarm tatimor i përgatitur nga "A.R.S Legal & Financial Services" shpk, ju ofron informata të vlefshme për personat fizikë dhe juridikë mbi ndryshimet më të fundit në legjislacionin Shqiptar të muajit Shkurt.

Në fletoren zyrtare Nr. 25 datë 28.02.2020 është publikuar Udhëzimi Nr. 8, datë 14.02.2020 "Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin Nr. 26, datë 04.09.2008 "Për taksa kombëtare", të ndryshuar.

Taksa vjetore e mjeteve të përdorura të transportit është taksë vjetore për çdo vit kalendarik nga 1 janari deri më 31 dhjetori të vitit përkatës, e cila llogaritet, paguhet dhe ka vlefshmëri 365 ditë, pavarësisht nga momenti në të cilën ajo paguhet.

Pronari i mjetit, i cili nuk kryen pagesën e kësaj takse brenda 10 ditëve nga mbarimi i afatit të vlefshmërisë së parashikuar, detyrohet të paguajë një gjobë prej 0.06 për qind të shumës së detyrimit të papaguar për çdo ditë vonesë nga dita e fundit e vlefshmërisë. Në asnjë rast, gjoba nuk llogaritet për një periudhë më të gjatë se 365 ditë kalendarike.

Shembull:

Mjeti me cilindrata 2993 cm³, me naftë dhe vit prodhimi 2003, për vitin 2018 ka paguar taksën vjetore të mjeteve të përdorura në datën 22.09.2018, në vlerën 16,462 lekë me afat vlefshmërie deri me 22.09.2019. Më datën 20.1.2020, pronari i mjetit paraqitet për të paguar taksat e vitit 2019 për mjetin dhe ka lindur detyrimi i taksave edhe për vitin aktual 2020. Llogariten dhe paguhet taksat e vitit 2019 në vlerën 17,958 lekë, por duke qenë se i ka kaluar

TAX ALERT

3 March 2019

To keep you up to date with the latest changes in Albanian legislation, this tax alert prepared by "ARS Legal & Financial Services" Ltd provides you with valuable information for legal person and legal entities on the latest changes on Albanian legislation during February.

In the Official Journal No. 25, dated 28.02.2020 is published the Instruction No. 8, dated 14.02.2020 "For some additions and changes to the instruction no. 26, dated 04.09.2008 "On national taxes", as amended.

The annual tax on used vehicles is an annual tax for each calendar year from 1 January to 31 December of the relevant year, which it is calculated, paid and valid for 365 days, regardless of the time at which it is paid.

The owner of the vehicle, who fails to pay this tax within 10 days of the expiry of the foreseen validity period, is obliged to pay a fine of 0.06 percent of the outstanding liability for each day of delay from the last validity day. In no case shall the penalty be calculated for a period exceeding 365 calendar days.

Example:

The vehicle with cylinders 2993 cm³, diesel and year of production 2003, for 2018 has paid annual tax on used vehicles on 22.9.2018, in the amount of 16,462 ALL with validity until 22.9.2019. On 20.1.2020, the owner of the vehicle appears to pay the 2019 taxes on the vehicle and the tax liability arises for the current year 2020. The 2019 taxes are calculated and paid in the amount of ALL 17,958, but having passed the validity period of 120 calendar days

afati i vlefshmërisë prej 120 ditësh kalendarike duhet të paguajë gjobë për pagesë të vonuar në shumën 1,293 lekë (17,958 lekë x 120 ditë x 0.06% = 1,293 lekë). Në total detyrimet për vitin 2019 janë në shumën 19,251 lekë. Duke qenë se pronari i mjetit është paraqitur më datë 20.01.2020, vlefshmëria për vitin në vazhdim llogaritet nga data 01.01.2020. Për këtë arsye, përveç taksës së vitit 2019, pronari i mjetit detyrohet të paguajë edhe detyrimin për vitin 2020, në shumën 19,455 lekë dhe gjobë për pagesë të vonuar prej 233 lekë (19,455 x 20 ditë x 0.06 %). Në total vlera e taksave për vitin 2020 që duhet të paguajë është 19,688 lekë, me afat vlefshmërie deri më 20.01.2021.

Në Fletoren Zyrtare Nr. 22, datë 24 Shkurt 2020 është botuar Vendimi Nr. 141, datë 13.2.2020 "Për përcaktimin e Veprimtarive, Kriterëve dhe Procedurave për Personat Juridikë që ushtrojnë veprimtari ekonomike në Industrinë Automotive".

1. Aktivitetet që përfshihen në industrinë automotive

Për qëllim të zbatimit të shkallës 5% të tatimit mbi fitimin, në industrinë automotive përfshihen tatimpaguesit që janë të regjistruar si të tillë dhe kryejnë aktivitetet e prodhimit të mjeteve motorike ose të pjesëve përbërëse të tyre.

Përjashtim: Kjo industri nuk përfshin tatimpagues që kryejnë aktivitete për mirëmbajtjen e mjeteve motorike apo shërbime të tilla si riparimet.

2. Kriteret për aplikimin e tatimitit nga personat juridikë që ushtrojnë këto aktivitete

Personi juridik, për të zbatuar shkallën tatimore (5%) sipas ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, "Për tatimin mbi të ardhurat", të ndryshuar, duhet:

must pay a fine for late payment at the amount of ALL 1,293 (ALL 17,958 x 120 days x 0.06% = ALL 1,293). In total, liabilities for 2019 are in the amount of 19,251 ALL. As the owner of the vehicle is presented on date 20.1.2020, the validity of the following year is calculated from 01.01.2020. For this reason, besides the 2019 tax, the vehicle owner is obliged to pay the obligation for 2020, in the amount of 19,455 ALL and the fine for late payment of 233 ALL (19,455 x 20 days x 0.06%). In total the value of taxes for the year 2020 that has to pay is 19,688 ALL, with validity up to 20.01.2021.

In the Official Journal No. 22, date 24 February 2020 is published Decision No. 141, dated 13.2.2020 "On the determination of the Activities, Criteria and Procedures of all Legal Entities exercising economic activity in the Automotive Industry".

1. Activities involved in the automotive industry

For the purpose of applying the 5% rate of profit tax, the automotive industry includes taxpayers who are registered as such and carry out the activities of producing motor vehicles or their components.

Exceptions: This industry does not include taxpayers who carry out activities for the maintenance of motor vehicles or services such as repairs.

2. Criteria for the application of taxation by legal entities carrying out these activities

Legal person, in order to apply the rate (5%) specified in law no. 8438, dated 28.12.1998, "On Income Tax", as amended, shall:

- të kenë specifikuar në objektin e veprimtarive të njësisë ekonomike veprimtaritë ekonomike të prodhimit të mjeteve motorike ose pjesëve përbërëse të tyre;
- të realizojë jo më pak se 100% të qarkullimit vjetor në aktivitetet ekonomike të prodhimit të mjeteve motorike ose pjesëve përbërëse të tyre;
- të ketë të punësuar mesatarisht gjatë vitit financiar jo më pak se 250 (dyqind e pesëdhjetë) punonjës.

3. Procedura

Personi juridik paraqet pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore përkatëse një deklaratë me shkrim, ku tregon plotësimin e kriterëve sipas këtij vendimi.

Kusht: Personi juridik, i cili aplikon shkallën tatimore prej 5 (pesë) %, sipas ligjit “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar, duhet të zhvillojë vetëm veprimtari të fushës së industrisë automotive.

Nëse personi juridik zhvillon edhe veprimtari të tjera ekonomike, ai duhet të regjistrohet si subjekt tatimor më vete.

Autoriteti Përgjegjës për zbatimin e këtij vendimi: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve.

Nëse dëshironi të dini më shumë për ndryshimet në legjislacionin Shqiptar, na kontaktoni si më poshtë:

Email: info@arsfirm.al
Telefon: +355 69 978 9625
Ëeb: ëëë.arsfirm.al

Adresa e zyrës
Rruga "Kavaja" Qendra " Sun Toëer " Kati 8,
Apt nr. 30, Tiranë, Shqipëri
©A.R.S Legal & Financial Services

- have specified in the object of the entity's activities the economic activities of producing motor vehicles or their components;
- realize not less than 100% of the annual turnover in the economic activities of the production of motor vehicles or their components;
- have at least 250 (two hundred and fifty) employees on average during the financial year.

3. Procedure

The legal entity shall submit to the relevant Regional Tax Directorate a written statement indicating the fulfillment of the criteria under this decision.

Condition: Legal entities applying the tax rate of 5 (five)%, according to law “On Income Tax”, as amended, should only exercise activities in the field of automotive industry. If the legal entity exercise other economic activities, it must be registered as a separate taxable person.

Responsible Authority for the implementation of this decision: General Directorate of Taxation

If you wish to know more on Albanian Legislation changes, contact us as follows:

Email: info@arsfirm.al
Phone: +355 69 978 9625
Web: www.arsfirm.al

Office Address
“Kavaja” Street ,“Sun Tower” Center, 8th Floor, Apt no. 30, Tirana, Albania
©A.R.S Legal & Financial Services

